



Konferenca hyrëse

AGJENDA

Barabarësia: Parakusht për Ripërtrirje të Demokracisë

14. - 15. mars 2023

Dita 1: 14 mars 2023

9:30-10:00 Arritja e pjesëmarrësve

10.00-10.15 Fjalët hyrëse

- Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtore, NDI Kosovë
- Zeinah Salah, Drejtore e Misionit, USAID Kosovë
- Katharina Stocker, Drejtore e Zyrës për Bashkëpunim, Ambasada e Zvicrës, Kosovë

10:15- 10:35 Fjala kryesore: “Rëndësia e barabarësisë dhe gjithëpërfshirjes në demokraci”

Demokracia po shënon regres, jo vetëm në rajon, por globalisht, pasi sundimtarët autoritarë vendosin kufizime në funksionimin demokratik të qeverisë dhe kufizime në shprehjen e lirë dhe të drejtat e tjera themelore të njeriut. Ky fjalim kryesor do të fokusohet në rëndësinë dhe obliminin e qeverive që të propozojnë dhe implementojnë politika që përqafojnë diversitetin, barazinë dhe gjithëpërfshirjen si parime kryesore në arritjen e unitetit, për të siguruar mbrojtjen dhe ripërtrirjen e demokracisë.

- Shkëlqesia e Saj, Dr. Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës
- Shanthi Kalathil, Anëtare e bordit, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

10.40-11.30 Diskutim i hapur “Barazia, barabarësia dhe drejtësia”

Integrimi i barabarsisë si parim kyç në politikëbërje është çelës për krijimin e një shoqërie të drejtë. Me integrimin e këtij parimi, qeverive u mundësohet t'u përgjigjen nevojave unike të grupeve të ndryshme, duke trajtuar kështu pabarazitë sistematike dhe duke ndërtuar një demokraci më të qëndrueshme që i përgjigjet të gjithë qytetarëve. Në këtë bisedë të hapur, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të diskutojnë mbi gjendjen e përgjithshme të demokracisë në vend përmes perspektivës së barabarësisë, sfidat dhe mundësitë e integritit të këtij parimi në proceset e politikëbërjes.

- Shkëlqesia e Tij, Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës
- Flaka Zogu, Gazetare

11:30 - 12:00 Pauza e kafes

12:00 - 13:30 Rrjetëzimi si avantazh konkurrues për angazhim ekonomik dhe politik të grave

Varësia financiare dhe qasja e kufizuar në grupe rrjetëzimi mbeten disa nga barrierat më të mëdha për avancimin e profileve politike të grave dhe në arritjen e potencialit të tyre të plotë politik. Ky panel diskutimi synon të shqyrtojë ndërvarësinë ndërmjet fuqizimit ekonomik të grave dhe pjesëmarrjes së tyre kuptimplotë në politikë. Më konkretisht, synon të analizojë nëse ekspozimi më i madh ndaj rrjeteve dhe qasja në burime mund ndikojnë në pavarësinë ekonomike të grave dhe në këtë mënyrë edhe në angazhimin e tyre aktiv politik.

**Adresim virtual: Valeriya Mechkova, Profesor asistent,
Universiteti i Gotenburgut, Suedi**

- Mimoza Kusari-Lila, Deputete, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Hykmete Bajrami, Deputete, Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Bali Muharremaj, Kryetar, Komuna e Suharekës
- Svetlana Stefanović, Drejtore Ekzekutive, BFPE
- Iliriana Gashi, Drejtore Ekzekutive, Kosova Women 4 Women

Moderatore: Leonora Kusari, EBRD, Kosovë

13:30-14:30 Dreka

14:30 - 16:00 Fuqizimi i liderëve të rinjë për reformim demokratik

Gratë dhe të rinjtë kanë demonstruar cilësi të jashtëzakonshme të lidërsipit prandaj përfshirja e tyre në hartimin e politikave është hap imperativ drejt arritjes së ripërtrirjes demokratike. Ky panel diskutimi do të shqyrtojë sfidat e grave dhe të rinjëve në politikë duke përfshirë qasjen e tyre në burime, mundësitë për vendimmarrje dhe mentorim, si dhe do të diskutojë nevojën për miratimin e reformave strukturore nga partitë politike - veçanërisht në identifikimin, emërimin, përzgjedhjen dhe përgatitjen e grave dhe të rinjëve si kandidatë.

- Behar Jashari, Kryetar, Rinia për Vetëvendosje, Lëvizja Vetëvendosje
- Arbnora Salihu, Kryetare, Rinia Demokratike, Partia Demokratike e Kosovës
- Paris Guri, Kryetar, Forumi Rinor, Lidhja Demokratike e Kosovës
- Amire Ajeti, Kryetare, Aleanca e të Rinjve të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
- Jeton Rrahmani, Koordinator, Forumi Rinor, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës

Moderator: Krenare Gashi Krasniqi, Drejtore, RYCO, Kosovë

Dita 2: 15 mars 2023

9:30-10:00 Arritja e pjesëmarrësve

10:00 -10:05 Fjala hyrëse

- Alan Bowman, Ambasador i Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë

10.05- 10.15 Fjala kryesore: “Barabarësia: parakusht për ripërtrirje të demokracisë”

Demokracia kërkon forcim dhe kujdes të vazhdueshëm dhe ndonëse ndonjëherë shfaqen mangësi, ajo ofron paqe dhe prosperitet për qytetaret e saj. Ky fjalim kryesor do të fokusohet në rëndësinë dhe obliminin e qeverive që të propozojnë dhe implementojnë politika që përqafojnë diversitetin, barazinë dhe gjithëpërfshirjen si parime kryesore në arritjen e unitetit, për të siguruar mbrojtjen dhe ripërtrirjen e demokracisë.

- Shkëlqesia e Tij, Ritchie Torres, Anëtar i Kongresit Amerikan

10.15- 11.00 Integrimi i platformës 50/50 në strukturat partiake

Pavarësisht shenjave të qarta të progresit, gratë dhe të rinjtë në partitë politike në Kosovë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar. Si rezultat, nevojat dhe interesat e tyre prioritare shpesh nuk adresohen në politikëbërje, gjë që në fund minon potencialin të plotë të demokracisë. Kështu, parti të ndryshme në mbarë botën kanë miratuar ndryshime strukturore për të përfaqësuar më mirë gratë dhe të rinjtë. Në këtë bisedë të hapur pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të kuptojnë mbi sfidat dhe mundësitë e integritit të platformës 50/50.

- Memli Krasniqi, Kryetar, Partia Demokratike e Kosovës
- Debora Peci, Menaxhere e Projektit, Democracy plus (D+)

11.00 - 12.30 Qeverisja lokale: Rruga drejt një mjedisi gjithëpërfshirës që garanton suksesin e grave

Gratë vazhdojnë të përballen me një mjedis të ashpër politik dhe pengesa të mëdha drejtë angazhimit të tyre kuptimplotë në pozita vendimmarrëse. Ky panel do të diskutojë sfidat unike me të cilat gratë përballen gjatë kandidimit për qeverisje lokale, barrierat e tyre pasi të arrijnë pozita vendimmarrëse si dhe sfidat e tyre gjatë angazhimit si qytetare dhe votuese. Konkretisht, çfarë mbetet për të bërë nga partitë politike dhe institucionet lokale për të krijuar një mjedis të favorshëm që garanton suksesin e grave.

Adresim virtual: Blerta Hoti, Nënkyetare, Komuna e Gotenburgut, Suedi

Thierry Apothéloz, Këshilltar Shtetëror, Gjenevë, Zvicër

- Jehona Lushaku, Kryetare e Forumit të Gruas, Lidhja Demokratike e Kosovës
- Diellza Kukaj, Kryetare e Aleancës së Gruas së Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
- Filloreta Hoti, Kryetare e Këshillit të Fshatit, Gjakovë
- Abdülhadi Krasniç, Kryetar i Komunës, Mamushë, Partia Demokratike Turke e Kosovës

Moderator: Caleb Waugh, Analist i Politikave, NGO AKTIV

12:30 - 13:30 Dreka

13:40 - 15.00 Aspirata për media gjithëpërfshirëse: Përfaqësim dhe raportim i balancuar gjinor dhe i bazuar në diversitet

Media luan një rol shumë të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik, çka do të thotë se çdo lloj stereotipi gjinor, i qëllimshëm ose jo, ka pasoja. Në këtë diskutim, panelistët do të ofrojnë perspektivat e tyre lidhur me mundësitë e mediave për të integruar qasje të ndjeshme gjinore dhe hapat që duhet ndjekur për politika dhe praktika që promovojnë një përfaqësim të balancuar gjinor dhe gjithëpërfshirës.

- Shkumbin Ahmetxhekaj, Drejtor, Radio Televizioni i Kosovës
- Adriatik Kelmendi, Drejtor Ekzekutiv, Klan Kosova
- Dafina Halili, Redaktore dhe Gazetare, Kosovo 2.0
- Amina Omid, Gazetare, Programi “Gazetarët në Rezidencë” (JiR), Afganistan

Moderator: Adea Beqaj, Zyrtare e Lartë e Programit, NDI Kosovë

15:00-15:20 Pauza e kafes

15:20 - 15:45 Shfaqja e dokumentarit “Çmimi i lartë për gratë në lidhësi me: Dhuna ndaj Grave në Politikë ”

15:45 - 16:20 Diskutim i hapur mbi dokumentarin

Gjersa gratë vazhdojnë të shënojnë progres duke u bashkuar në jetën politike, ato ekspozohen në një mjedis të ashpër politik të krijuar nga kundërshtarët e barazisë gjinore me synimin për të minuar pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe për të kontribuar në dekurajimin e grave dhe vajzave të reja të bashkohen në politikë. Kjo bisedë e hapur do të adresoj rolin e insitucioneve vendimmarrëse në luftimin e këtij fenomeni për të mundësuar një kulturë politike dhe një diskurs politik gjithëpërfshirës.

- Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë, Republika e Kosovës
- Kaltrina Rexhepi, Gazetare

16.20 - 16.30 Fjalët përmbyllëse

- Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtore, NDI Kosovë



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

